



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-CA-2023-02

**Vendosi:** Kryetarja e Dhomave të Specializuara  
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 7 shkurt 2023

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Konfidencial

---

## Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit

---

**Gjykatësve të Panelit të Gjykatës së Apelit:**

Gjykatëse Mishelë Pikar

Gjykatës Kai Ambos

Gjykatëse Nina Jorgensen

**Ushtruesit të Detyrës së Prokurorit të Specializuar:**

Aleks Uajting

**Mbrojtësit të Salih Mustafës:**

Julius von Bone

**Mbrojtëses së Viktimave:**

Ani Pues

**KRYETARJA** e Dhomave të Specializuara (“Kryetarja”), në bazë të neneve 33(1)(c), dhe 46(1) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”), rregullave 172 dhe 173(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), dhe rregullave 3 dhe 4 të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve të Dhomave të Specializuara nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë (“Rregullorja për Caktimin e Gjykatësve”), me anë të këtij vendimi cakton një Panel të Gjykatës së Apelit për të vendosur në lidhje me Njoftimin e Mbrojtjes për Apel sipas Rregullës 176 (të Rregullores së Procedurës dhe të Provave) kundër Vendimit të Trupit Gjykues I të datës 16 dhjetor 2022” (“Njoftimi për Apel”).<sup>1</sup>

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 16 dhjetor 2022, Trupi Gjykues I shpalli Aktgjykimin, ku, ndër të tjera, e dënoi z. Salih Mustafa për ndalim arbitrar, torturë dhe vrasje si krime lufte dhe e shpalli të pafajshëm për trajtim mizor si krim lufte.<sup>2</sup> Trupi Gjykues e dënoi z. Mustafa me 26 vjet burgim.<sup>3</sup>
2. Më 3 janar 2023, z. Mustafa dorëzoi një kërkesë për shtyrje të afatit për dorëzimin e njoftimit të tij për apel (“Kërkesa”).<sup>4</sup>
3. Më 9 janar 2023, Paneli i Gjykatës së Apelit i caktuar për gjykimin e Kërkesës së z.

---

<sup>1</sup> F00006, Njoftim për Apel i Mbrojtjes në bazë të Rregullës 176 (të Rregullores për Procedurat dhe Provat) kundër Vendimit të Trupit Gjykues I të datës 16 dhjetor 2022, 2 shkurt 2023 (konfidencial).

<sup>2</sup> KSC-BC-2020-05/F00494, Aktgjykim, dorëzuar më 16 dhjetor 2022 (konfidencial), paragrafi 831. Versioni i redaktuar publik i Aktgjykimit u dorëzua më 19 janar 2023. Shih KSC-BC-2020-05/F00494/RED. Një version i korrigjuar i versionit të redaktuar publik u dorëzua më 24 janar 2023. Shih KSC-BC-2020-05/ F00494/RED/COR.

<sup>3</sup> Aktgjykimi, paragrafi 831.

<sup>4</sup> F00001, Mocion Urgjent i Mbrojtjes për Shtyrje të Afatit për Dorëzimin e Njoftimit për Apel, 3 janar 2023.

Mustafa, e miratoi atë, duke e shtyrë afatin deri më 3 shkurt 2023.<sup>5</sup>

4. Më 2 shkurt 2023, z. Mustafa dorëzoi Njoftimin për Apel.<sup>6</sup>

## II. KLASIFIKIMI

5. Njoftimi për Apel është klasifikuar si konfidencial dhe për rrjedhojë ky vendim do të ketë të njëjtin klasifikim në pajtim me rregullën 82(4) të Rregullores, derisa të riklasifikohet më vonë në pajtim me rregullën 3(4) të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve.

## III. CAKTIMI

6. Pas shqyrtimit të kriterëve të përcaktuara në rregullën (2) të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve, duke përfshirë përvojën dhe kompetencën përkatëse, si edhe disponueshmërinë në këtë moment,

### **KRYETARJA ME KËTË VENDIM CAKTON:**

**Gjykatësen Mishelë Pikar**

**Gjykatësin Kai Ambos**

**Gjykatësen Nina Jorgensen**

në Panelin e Gjykatës së Apelit për të vendosur mbi apelin ndaj aktgjykimit.

---

<sup>5</sup> F00004, Vendim në lidhje me Mocionin e Mbrojtjes për Ndryshimin e Afatit për Dorëzimin e Njoftimit për Apel, 9 janar 2023.

<sup>6</sup> Shih Njoftimin e Apelit. Kryetarja vëren se z. Mustafa e dorëzoi Njoftimin për Apel para një paneli të ngritur më parë të Gjykatës së Apelit, i cili pushoi së ekzistuari pas dorëzimit të këtij njoftimi. Si rrjedhojë, Kryetarja do të caktojë një panel të Gjykatës së Apelit për të vendosur mbi apelimin kundër Aktgjykimit, në përputhje me nenin 33(1)(c) të Ligjit dhe rregullën 172 të Rregullores.

/nënshkrimi/

**Gjykatëse Ekaterina Trendafilova,**  
**Kryetare e Dhomave të Specializuara**

E martë, 7 shkurt 2023  
Në Hagë, Holandë